



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.917/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtar, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditëses Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SHA me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, me bazë juridike: anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative K.A.nr.306/22 të datës 01.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SHA me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative K.A.nr.306/22 i datës 01.03.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, është Refuzuar si e pabazuar Kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SHA nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.V_1234_2020 datës 12.02.2020 i paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë.

Kundër këtij Aktgjykimi, pala paditëse, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.306/22 të datës 01.03.2024, ashtu që të aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SHA me seli në Prishtinë, dhe të anulohet vendimi i ZRRE-së nr.V_1234_2020 datës 12.02.2020 si i pabazuar, apo të anulohet aktgjykimi ankiomor, dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave e paditura Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me vendimin kontestues V_1234_2020 datës 12.02.2020, ka Refuzuar ankesën e KESCO-së, ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin L.B. nga Prishtina, me shifer konsumatorit DPR-..., si të pabazuar, dhe ka lënë në fuqi vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e konsumatorve nr.ZRRE/DMK_V_2013_12_19 dt.17.12.2019.

Paditësi ndaj këtij vendimi përfundimtar në procedurën administrative, me padin e datës 15.04.2020 ka inicuar në gjykatë, konflikt administrativ kundër të paditues, me të cilën ka kërkuar aprovimin e padis dhe anulimin e vendimit të paditues. Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 01.03.2024 në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyëse, dhe administrimit të provave, me Aktgjykimin K.A.nr.306/22 datës 01.03.2023, ka Refuzuar kërkespadin e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.V_1234_2020 datës 12.02.2020 i paditurit Bordi të Zyrës së Rregullatorit për Energji në Prishtinë.

Dhoma e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit thekson se i padituri ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejt gjendjen faktike, se paditësi nuk e ka provuar faktin se njëtori elektrik nr.39360867, i cili ishte lidhur ilegalisht në rrjetin elektrik e ka funizuar banesën ose ndonjëhapësire tjetër të konsumatorit L.B.. Në procesverbalin përkatës vetëm ishte konstatuar se njëtori është i lidhur ilegalisht në rrjetin elektrik, pas specifikuar se cila banese ose objekt ëdhte duke u furnizuar nga ai njëtori. Përveq kësaj vet paditësi së pari ia kishte montuar konsumatorit njëtorin nr.39700119 me pëlqim energjik, ndërsa me dt.10.05.2016 atë njëtori e kishte ndërruar me njëtorin 39360867 në bazë të urdhëresës, dhe këto veprime për gjykatën nuk janë të mjaftueshme për ta krijuar lidhjen ndërmjet konsumatorit në fjalë dhe njëtorit nr.39360867. Meqe nuk ka prova që e lidhin konsumatorin me shpenzimin e energjisë elektrike nga njëtori 39360867, atëher edhe faturimi i shpenzimit ka qenë i jashtëligjshëm. Më tej gjykata në arsyetim të aktgjykimit arsyeton pretendimet e paditësit lidhur me afatshmërin e ankesës së konsumatorit ndaj vendimit të paditësit, dhe ka nxjerr konstatimin se në shkresat e lëndës nuk ka prova se kur konsumatori ka pranuar vendimin e paditësit, ndërsa neni 9 par.3 i Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesve në Sektorin e energjise, nuk mund të zbatohet.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike apo zbatim të gabuar të drejtës materiale, sikurse pretendon paditësja në ankesë.

Pretendimet ankimore të paditësit, se gjykata e shkallës së parë, ka dështuar të kujdeset për afatet në të cilat konsumatori ka pasur të drejtën të ushtroj të drejtat e tij, konkretisht ankesën ndaj fatures kontestuese, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, i refuzoi si të pabazuara, këto pretendime në baza ligjore, për arsye se në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetimet e duhura ligjore, se në mungesë të provave se kur konsumatori e ka pranuar vendimin e paditësit, nuk mund të zbatohet neni 9 par.3 i Rregullores për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve. Kolegji vlerëson se përkundër faktit se neni 13 par.1 i Rregulles për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjise, parasheh dy alternativa të afatit për paraqitje të ankesës, 1. në afatin ligjor prej 14 ditësh kalendarike nga dita e pranimin të vendimit, 2. nga data kur afati përfundimtar për shqyrtimin e ankesës nga furnizuesi ka kaluar, siq përcaktohet në nenin 9.3 të kësaj Rregulle. Prandaj Kolegji vlerëson, se në këtë kuptim paditësi nuk ka ofruar prova para gjykatës së shkallës së parë, datën se kur e ka pranuar konsumatori vendimin apo faturen kontestuese sikurse pretendon në ankesë, për tu llogaritur afati i lejueshmërisë së ankesës në procedurën administrative, dhe për tu vërtetuar se ankesa është paraqit jashtë afatit ligjor.

Kolegji vlerësoi se aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë nuk ka të meta në aspektin e vërtetimit të gjendjes faktike, për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhomat e Shkallës së Dytë.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vlerësoi gjithashtu edhe pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka vlerësuar se nuk është arrit të vërtetohet se konsumatori ishte furnizuar me energji elektrike nga njehsori elektrik i kyqur ilegalisht. Nga provat e lëndës rezulton se nga procesverbalet e inspektimit dt.26.03.2016, procesverbalit të pranimin teknik të njehsorit 39700119, procesverbalit për ndërrimin e njehsorëve 0589585 dt.10.05.2016 dhe nr.0607728 dt.10.05.2016, ekzistojnë kundërtënie sa i përket argumentimit se njehsori elektrik nr.39360867 ka qenë i vendosur më herët nga konsumatori për matje, përderisa pranimin i parë teknik nga ekipi i KEDS-it, është bërë për njehsorin elektrik nr.39700119 në emrin e konsumatorit, ndërsa në procesverbalin e inspektimit dt.26.03.2016 evidentohet se njehsori nr.39360867 nuk evidenton se cilën banës e furnizon me energji elektrike.

Prandaj nga kjo gjendje e rrjedhës së energjisë elektrike aktive, e evidentuar në periudhën kohore të krahasuar, edhe Kolegji pranon konstatimet se nuk është arritur të argumentohet fatura nr.0716210393DPR-... dt.01.08.2016 respektivisht shpenzimin e faturuar të energjisë elektrike nga konsumatori.

Nga një gjendje e tillë faktike nga e cila rezulton se paditësi nuk ka bërë një vlerësim të drejt të gjendjes faktike, gjatë matjes së shpenzimit real të energjisë elektrike, kur ka ngarkuar konsumatorin me ngarkese në shpenzimin e energjisë elektrike sipas korigjimit plotësues, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, i vlerëson si të drejta konstatimet e paditurës dhe gjykatës së shkallës së parë, e cila në procedurë të konfliktit administrativ, vërteton drejt gjendjen faktike, dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore, me të drejt refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Dhomat e Shkallës së Dytë, gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankesë, gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 44 të LKA-së dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vet gjendjen faktike, dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë, mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallë së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.917/24 datë 16.05.2024

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Krenar Berisha